

# FESTIVALI I KULTURAVE

Kontribuar nga Administrator  
 Sonntag, 13 Mai 2012  
 Azhornuar së fundi Sonntag, 13 Mai 2012

Më datën 06. Maj 2012 në sallën e quajtur "Schlachthof" u oragnizua Festivali i kulturave. Është një festival i madh kulturor që organizohet në qytetin e Eëlsit të Austrisë së Eperme dhe që njëherazi shënon fundin e muajit "Prill" i shpallur dhe i quajtur "muaji i respektit dhe tolerancës". Gjatë këtij muaji organizohen aktivitete të ndryshme kulturore dhe fetare nga shoqata dhe organizata të ndryshme, veprimtari këto që i shërbejnë integritit më të mirë të nacionaliteteve pakicë me shumicën austriake.

Kështu si përfundim i këtyre aktiviteteve njëmujore, organizohet festivali i kulturave. Një program i pasur me muzik popullore, vallëzime dhe performancë, tregon shumëllojshmërinë kulturore në qytetin tonë duke ofruar ngapak për shijën e çdokujt. Festivali në fjalë vitet e fundit është shndërruar në një vend takimi, ku takohen njerëz nga të gjitha nacionalitetet dhe me rrënjë të ndryshme kulturore dhe fetare.

Shoqta e shqiptarëve musliman në Wels "Mesxhid err-Rresul" mori pjesë në këtë Festival duke prezantuar me kulturën ushqimore. Shumë familje shqiptarë që jetojnë në këtë qytete përgatitën specialitet ushqimore shqiptare, të cilat u vlerësuan nga të gjithë të pranishmit, por edhe nga autoritetet e komunës dhe në përgjithësi nga të gjithë viztuesit dhe pjesmarrësit në këtë festival.

Pastaj, artikujt e ndryshëm ushqimor që ishin përgatitur enkas për këtë ditë u shitën me një cmim simbolik dhe u destinuan si një kontribut modest për ndërtimin e "QENDRËS KULTURORE MODRNE SHQIPTARE", për të cilën para disa kohësh është bërë pagesa e trolit të saj me një hapësirë prej 5.800 m2.

Falënderojmë të gjitha familjet shqiptare që kontribuan në përgatitjen e këtyre artikujve ushqimor dhe që nëpërmjet këtij aktiviteti i siguruan pika të vlefshme dhe pozitive emrit dhe afirmimit të komunitetit tonë dhe shoqatës sonë. Në vazhdim do t'i përmendim të gjitha ato familje dhe persona që kontribuan që ky aktivitet të jetë në nivelin e duhur.

1. Muhidin Ahmeti - Imami i xhamis
2. Sadulla Fetai - Kryetari
3. Ragmi Ramani – Arkatari
4. Bejtush Jakupi – Sekretari
5. Nysret Rahimi – Anetar i kryesise
6. Sevdail Ramizi – Anetar i Kryesise
7. Sejdi Salihu
8. Nijazi Ibishi
9. Nuri Saliji
10. Ali Sallahi
11. Raman Rexhepi

12. Fersan Jahiu
13. Shpend Zulfiu
14. Sali zendeli
15. Naser Salihu
16. Emin Jahia
17. Rexhep Sulimani
18. Seada Abazi
19. Nexhat Bajrami
20. Nehat Memeti
21. Gazmend Memeti